



Instituti për
Kontabilitet
Auditim
Financa

Instituti KAF

Shoqatë Profesionale për Çertifikimin e Kontabilistëve dhe Auditorëve
(të Brendshëm dhe të Jashtëm)

Licencuar/ Akredituar nga Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar (KKRF) dhe
Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK)

K O N K U R S

Për regjistrimin e kandidatëve në Institutin KAF
**“Auditor i Brendshëm i Certifikuar
në Sektorin Privat dhe Publik”**

Afati, Tetor/2017



K O N K U R S

Për regjistrimin e kandidatëve në Institutin KAF Afati, Tetor 2017

Regjistrimi shpallet i hapur nga data 22.05.2017, përkatësisht deri në plotësimin e vendeve të lira.

1. AUDITORË I BRENDSHËM I CERTIFIKUAR NË SEKTORIN PRIVAT DHE PUBLIK

1.1. PËRMBAJTJA DHE ORGANIZIMI AKADEMIK I CERTIFIKIMIT

Përmbajtja e kualifikimit është zhvilluar në atë mënyrë që të sigurojë që kualifikimi ofron një sërë njohurishë, aftësishtë dhe teknikash profesionale për Auditor të Brendshëm. Syllabusi është zhvilluar duke iu referuar kërkesës për këtë profesion, Kodit të Etikës IIA, Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm IIA dhe Kornizës Ndërkombëtare të Praktikës Profesionale.

Kandidatët në kualifikimin për auditim të brendshëm duhet të demostrojnë njohuri në pesë module teorike:

KODI	MODULI
AB-P1	Mjedisi i Auditimit të Brendshëm
AB-P2	Menaxhimi Financiar
AB-P3	Praktika në Auditimin e Brendshëm
AB-P4	Auditimi i Sistemeve të Informacioneve
AB-P5	Qeverisja e Korporatave dhe Menaxhimi i Riskut

Kualifikimi për auditim të brendshëm është kualifikim profesional për ushtrimin e detyrës në gjitha sektorët ku nevojitet një intensifikim i njohurive në të gjitha aspektet e rolit të auditimit të brendshëm, menaxhimit të riskut, kontrollit dhe qeverisjes, në të cilat fusha operon auditori i brendshëm. Ndryshe nga gjitha kualifikimet tjera, ky kualifikim është i dizajnuar në mënyrë specifike për të bashkërenduar nevojat e auditimit të brendshëm dhe llogaritet si një benchmark për profesionin, bazuar në standardet e njohura ndërkombtarisht.

2. Kushtet, kriteret dhe afatet për regjistrim

2.1. Afatet për paraqitje dhe regjistrim

Kandidatët e interesuar mund të paraqiten duke filluar nga data 22.05.2017.

- Afati i I-rë i regjistrimit nga data 22.05.2017 deri me datën 30.06.2017
- Afati i II-të i regjistrimit nga data 01.07.2017 deri me datën 31.08.2017
- Afati i III-të i regjistrimit nga data 01.09.2017 deri me datën 30.09.2017

2.2. Paraqitja e kandidatëve

Të drejtë paraqitjeje kanë të gjithë kandidatët që i përmbushin kushtet e parapara me konkurs. Kandidatët duhet t'i dorëzojnë të gjitha dokumentet përmes e-mailit: trajnimikaf@gmail.com.

2.3. Kriteret për regjistrim të kandidatëve në kualifikimin ABC

Kandidatët që kanë aplikuar për regjistrim për nivelin e caktuar profesional. Për regjistrim, kandidatët duhet të dorëzojnë:

- ✓ Formulari i Regjistrimit për ABC;
- ✓ Diploma e fakultetit/ Certifikata e Notave (kopje);
- ✓ Dëshmi për përvojën e punës (Vërtetim ose Kontrata e Punës) jo më pak se 3 vite (Obligative);
- ✓ Kandidatët me përvojë pune në auditim, përparësi në regjistrim;
- ✓ Kandidatët që nuk kanë përvojë pune në financa-administratë, kontabilitet, auditim, do t'i nënshtrohen testit pranues në IKAF;
- ✓ ID letërnjoftimi (kopje);
- ✓ CV-ja.

Të gjitha dokumentet duhet të dorëzohen me email, mirëpo para certifikimit tuaj dokumentet do ju kërkohen të motorizuara te Noteri.

2.4. Njohja e moduleve të caktuara apo transferet

Nëse mbani ndonjë kualifikim ju keni të drejtë që të aplikoni për njohje të kualifikimit apo moduleve: Më shumë detale: <http://ikaf.org/njohja-e-moduleve-kualifikimeve-tk-kc-ac/>.

Kandidatët të cilët aplikojnë për njohje të moduleve përveç dokumenteve të lartshënuara duhet të dorëzojnë me email edhe këto dokumente:

- Plotësimi i formularit për njohje të moduleve (www.ikaf.org/formularet)
- Vërtetimin e dhënies së moduleve të caktuara në një institucion apo shoqatë tjetër;
- Përvoja e punës.

3. KËRKESAT PËR MARRJEN E CERTIFIKATËS

Për tu pajisur me certifikatë profesionale “Auditor i Brendshëm i Certifikuar në Sektorin Privat dhe Publik”, duhet të plotësojë të gjitha kriteret në vijim:

- ✓ Të kenë përfunduar me sukses trajnimin, testimin dhe pjesën praktikative (Rast studimi) për “Auditor i Brendshëm në Sektorin Privat dhe Publik”;
- ✓ Në pesë (5) vitet e fundit nga ndonjë gjykatë kompetente se është vërtetuar se nuk ka kryer veprë penale që përfshin mashtrim, keqinterpretim, korrupsion, pastrim parash, keqpërdorim ose përvetësim të fondeve ose ryshfet sipas ligjeve të zbatueshme në Kosovë, ose sipas konventave apo traktateve ndërkombëtare;
- ✓ Kanë dorëzuar të Noterizuara dokumentet e kërkuara sipas pikes Nr.2.
- ✓ Është vërtetuar se nuk ka qenë i përfshirë në sjellje jo-profesionale nga ndonjë institucion ose organizatë përgjegjëse për zbatimin e standardeve të sjelljes profesionale;
- ✓ Nuk ka bërë paraqitje të shtrembëruara nën betim ose në ndonjë dokument të vulosur, të notarizuar ose zyrtar;

4. RASTI STUDIMOR – PJESA PRAKTIKE

1. Pas përfundimit me sukses të provimeve me shkrim, kandidati i nënshtrohet pjesës praktike konkretisht rastit studimor;
2. Pas aprovimit të abstraktit të cilin kandidati duhet ta dorëzoi, i jipet drita jeshile kandidatit për realizimin e rastit studimor në afat prej 60 ditësh.
3. Raporti i Auditimit vlerësohet në bazë të indikatorëve të performancës të përcaktuar nga organi kompetent brenda Institutit;

** Përjashtimisht, auditorët e brendshëm që i nënshtrohen programit për trajnim e që kanë tre (3) vite përvojë pune në auditim të brendshëm (në 6 vitet e fundit), nuk obligohen t'i nënshtrohen vlerësimit në kuadër të rastit studimor konkretisht pjesës praktike.*

5. PROGRAMI I TRAJNIMIT

Kodi	Modulet	Kreditë	Kohëzgjatja
AB-P1	Mjedisi i Auditimit të Brendshëm	15	200 Orë
AB-P2	Menaxhimi Financiar	15	
AB-P3	Praktika në Auditimin e Brendshëm	15	
AB-P4	Auditimi i Sistemeve të Informacioneve	15	
AB-P5	Qeverisja e Korporatave dhe Menaxhimi i Riskut	15	
	Rast Studimor (Raport i Auditimit të Brendshëm)		

Vendi ku organizohet trajnimi, ditët dhe orari

Vendi i trajnimit	Ditët	Orari
Prishtinë	E premte	17:00 – 21:00
	E shtune	09:00 – 16:00

KOSTO E CERTIFIKIMI ABC (CIA)

Nr	Përshkrimi	Kosto
1	Tarifa e aplikimit	100.00 €
2	Moduli AB-P1 (Trajnimi + Literatura)	220.00 €
3	Moduli AB-P2 (Trajnimi + Literatura)	220.00 €
4	Moduli AB-P3 (Trajnimi + Literatura)	220.00 €
5	Moduli AB-P4 (Trajnimi + Literatura)	220.00 €
6	Moduli AB-P5 (Trajnimi + Literatura)	220.00 €
7	Anëtarësia	60.00 €
8	<i>*Punimi - Rasti Studimor</i>	
9	GJITHSEJË KOSTOJA	1,260.00 €

**Punimi - Rasti Studimor, bazuar në pikën 4 të konkursit: 100 Euro*

Përjashtimisht, auditorët e brendshëm që i nënshtrohen programit për trajnim e që kanë tre (3) vite përvojë pune në auditim të brendshëm (në 6 vitet e fundit), nuk obligohen t'i nënshtrohen vlerësimit në kuadër të rastit studimor konkretisht pjesës praktike.

Shënim:

- Kandidatët që kanë paguar dhe vijuar trajnimin nënkupton se do të ulen në provim pas përfundimit të ligjëratave të secilit modul dhe lirohen në këto raste nga paraqitja dhe pagesa e provimit. (Sqarim: nuk mund të anulohet apo bartet e drejta për të hyrë në provim në një afat tjetër).
- Në raste të mos hyrjes apo mos arritjes së pikeve prej 50% e më shumë, kandidatët në afatet tjera duhet të paguajnë dhe paraqesin provimin në vlerë prej 65.00 Euro.
- Shikimi i testit është pa pagesë në datë të caktuar nga IKAF, kurse kërkesa për ri-vlerësim të testit është me pagesë në vlerën e kostos së provimit.

KONTAKTI

Për më shumë hollësi kontaktoni zyren qendrore të Institutit KAF:



+381 (0) 38 220 608



+377 (0) 44 118 346



trajnimikaf@gmail.com



www.ikaf.org



Rr.Bedri Pejani Nr.1 – 10000 Prishtinë, Kosovë